



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtoria e Administratës Zgjedhore**

Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN**

**PËR**

**“NGRITJEN DHE THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË KOMISIONIT TË ZONËS SË**  
**ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 11, PËR ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË**  
**BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”**

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 28, datë 16.8.2023, ka miratuar afatet proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023.

Me vendimin nr. \_\_, datë \_\_.8.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 11, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia e Lirisë” dhe “Partia Demokratike”.

Kryetari në detyrë i Bashkisë Kukës, me shkresën nr. 6607 prot., datë 18.8.2023, ka dërguar vendndodhjen e selisë së KZAZ-së në ambjentin e Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina”, kati i dytë, Kukës.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

**Erion META** Drejtoria e Administratës Zgjedhore

**Majlinda ÇELMETA** Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .8.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**“PËR NGRITJEN DHE THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË KOMISIONIT TË ZONËS SË  
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 11, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË  
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Ngritjen e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.
2. Mbledhja e parë e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, do të zhvillohet në selinë e KZAZ-së, njësia administrative Kukës, Pallati i Kulturës “Hasan Prishtina”, kati i dytë, në datën 23.9.2023.
3. Bashkia Kukës do të sigurojë infrastrukturën logjistike në selinë e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 3 vjet

K. Nogu \_\_\_\_\_  
E. Meta \_\_\_\_\_  
M. Çelmeta \_\_\_\_\_  
Y. Merkaj \_\_\_\_\_

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: .8.2023 Nr:  
Ora:



“Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24.9.2023”